DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-14/17 -III-
Data Datum Date 21.08.2013

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 05.08.2013
Nr. 0204-14/15

**PËR:** Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, Nr.01/011-8415, Pranuar me datë, 24.07.2013.**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/011-8415, të miratuar me datë 04.07.2013, ***KONFIRMON*** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.01/011-8415, për Këmbimin e pronës komunale me pronën private.
- Me rastin e këmbimit të pronës së paluajtshëm komunle me persona fizik dhe juridik,vlerësimin e pronave të cilat janë objekt i këmbimit, bëhet nga organi kompetent për vlerësim,ashtu siç është paraparë me paragrafin 6 të Ligjit nr.04 L-144, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-14/17
-III-
Data Datum Date 21.08.2013

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć*
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 05.08.2013
Br. 0204-14/15

**Za :** Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine Opštine Prizren

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIZREN, br.01/011-8415, Primljemo dana, 24.07.2013.**

Poštvani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodata k XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br.01/011-8415, usvojene dana 04.07.2013, ***POTVRDJUJE*** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže navaden ima puni pravni efekat .

- Odluka Br.01/011-8415, o Razmeni Opstinske imovine sa privatno imovinom.
- Prilikom razmene nepokretne opštinske imovine sa pravnim i fizičkim licim,procenjivanje imovine koja je objekat razmene,vrši nadležni organ za procenjivanje,onako kako je predvidjeno po paragrafu 6 Zakona br.04 L-144, za Davanja na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine .

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamankpremijera i Ministar MALS-a,**

**Kopija:** *Besnik Osmani,Generalni Sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima Uprava MALS-a*
*Arhivi MALS-a.*

Pranuar 24.07.2013

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data Datum Date 24.07.2013

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| -III- | 0204-14/15 | | |


Në bazë të nenit 6 dhe nenit 7 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të shkresës së MAPL Nr. 0104, të datës 24 o1 2013 për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01/011-13453 të datës 15 tetor 2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2013, mori këtë:

# VENDIM

## PËR RIKONFIRMIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, TË DATËS 15 TETOR 2011, Nr.01/011-13453 MBI KËMBIMIN E PRONËS

Neni 1

Aprovohet propozimi i Komisionit Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, ashtu që lejohet këmbimi i pronës në mes të KK Prizrenit dhe „Euro-Invest".

Neni 2

Objekt i këmbimit janë ngastra kadastrale me nr.4115/1 pronë e SHFMU „Mustafa Bakiu" me sipërfaqe prej 96.25 m² të kaloj në pronësi të Kompleksit „Euro-Invest" kurse ngastra kadastrale me nr. 3032 pronë e „Euro-Invest" Sh.p.k. me sipërfaqe prej 97.31 m² të kaloj në pronësi të SHFMU „Mustafa Bakiu".

Neni 3

Këmbimi i ngastrave kadastrale e përshkruar si në nenin 1 dhe 2, jepet me qëllim të drejtimit-rregullimit të mexhesë në mes të parcelave të cekura në nenin 2 të këtij vendimi me qëllim të rregullimit të murit rrethues dhe ndarës në mes të ngastrave të cekura.

Neni 4

Këmbimi i pronës do të bëhet sipas Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 5

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës që pas marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit të Komunës të nënshkruaj Kontratën mbi këmbimin e pronës në mes Komunës së Prizrenit dhe „Euro-Invest" Sh.p.k.

Neni 6

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori për Çështje Pronësore-Juridike dhe Avokati Publik Komunal.

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

## ARSYETIM

Drejtoria për Arsim i është drejtuar me kërkesë Komisionit Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për këmbimin e paluajtshmërive ndërmjet KK Prizrenit ngastrës kadastrale nr.4115/1 pronë e SHFMU „Mustafa Bakiu„ me ngastrën kadastrale nr.3032 pronë e "Euro-Invest„ Sh.p.k Prizren.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të tjera të lëndës ka vërtetuar se këtu në rastin konkret ekziston interesi i ligjshëm publik, ku Komuna e Prizrenit me këmbimin e pronave të lartcekura do të përfitonte rregullimin e mexhëve në mes të ngastrave kadastrale të cekura dhe do të funksionalizonte ngastrën kadastrale pronë komunale ku është ndërtuar muri rrethues i shkollës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-8415
Më 4 korrik 2013
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
01/011 8415 18.07.2013